

## AKT THEMELIMI

I

### SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “Royal Development Int” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- **Z. Marco Mancuso**, shtetas Italian, i datëlindjes 03/04/1994, lindur në Genova ITALI, banues në ITALI, Genova, Rruga: Venti Settembre 8/29, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. CA22733ME.
- **Z. Riccardo Serena**, shtetas Italian, i datëlindjes 04/10/1994, lindur në Genova ITALI, banues në ITALI, Genova, Rruga: Granara 6/12, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. CA03507MG.

#### *Pjesa e përgjithshme*

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 02/09/2022 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

#### NENI 1

##### *Emri*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**Royal Development Int SH.P.K.**”. Ndryshimi i emërimit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 2

##### *Forma*

Shoqëria tregtare “**Royal Development Int**” SH.P.K, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

#### NENI 3

##### *Zyra Qëndrore*

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Royal Development Int**” SH.P.K, do të ketë zyrën e saj qendrore ne: DURRES, Lagjja 2, Rruga Aleksander Goga, Zona Kadastrale 8512, Njesi me Nr.pasurie 22/540-N2.

~~3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.~~

#### NENI 4

##### *Objekti i veprimtarisë*

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Konsulencë dhe planifikim biznesi për kompanitë që operojnë në sektorët e energjisë, telekomunikacionit, efikasitetit të energjisë dhe mjeteve të transportit. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj tregtare.

#### NENI 5

##### *Kohëzgjatja*

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31.12.2050 dhe mund të shtyhet sipas ligjeve në fuqi.

#### NENI 6

##### *Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit*

Shoqëria tregtare "Royal Development Int" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### NENI 7

##### *Përgjegjësia e Ortakëve*

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "Royal Development Int" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

#### NENI 8

##### *Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat*

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Royal Development Int" SHPK është **100.000 (njëqindmije) Leke**, ndarë në **2 kuota**, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- **Z. Marco Mancuso** zotëron **1 kuota**, të barabartë me **60% të kapitalit** të Shoqërisë me vlerë **60.000 Lekë**.
- **Z. Riccardo Serena** zotëron **1 kuota**, të barabartë me **40% të kapitalit** të shoqërisë me vlerë **40.000 Lekë**.

---

#### NENI 9

##### *Organet e shoqërisë*

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të Shoqërisë do të përcaktohen në statutin e Shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

#### NENI 10

##### *Administratori*

10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Administratorët e Shoqërisë janë dhe kanë kompetenca të panvarura si me poshtë:

- Z. Marco Mancuso është administratori i përgjithshëm i Shoqërisë. Ai kryen veprimet e administrimit ligjor si dhe operacional, të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm.
- **Z. Alfred Kaca është administrator me të drejta të kufizuara.** Ai të drejtat e listuara në këtë Statut, pertakesisht : të hapë llogarite bankare të Shoqërisë; të punësojë dhe të manaxhojë personelin; të përfaqësojë Shoqërinë pranë çdo organi shtetëror shqiptar, si dhe në marrëdhënie me të tretët. Për të gjitha veprimet e tij të mesiperme, gjatë ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm të shoqërisë, Ai duhet të komunikojë dhe të informojë gjithashtu Administratorin tjetër të Shoqërisë.

#### NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

*Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.*

#### ORTAKËT THEMELUES

*Marco Mancuso*



*Riccardo Serena*



DURRES 10 / 11 / 2022

Per kthyer nga: Alfred Kaca<sup>3</sup> 